



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 139

Prishtinë, më 18.2.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-3

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci.

Munguan : Daut Haradinaj, Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.2.2014,
3. Caktimi i grupeve punuese për projektligjet e lexuara në parim,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke shtuar pikën për projektligjin e Kimikateve përkatësisht konfirmimin për leximin e dytë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.2.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 shkurt 2014.

3. Caktimi i grupeve punuese

Kryetari Nait Hasani filloi shqyrtimin e kësaj pike radhazi për projektligjet e lexuara në parim dhe u vendos si në vijim :

1. Grupi punues për zonën e Obiliqit : Ramiz Lladrovci, Daut Hajradini, Afërdita Berisha dhe Agim Kuleta.
2. Grupi punues për mbrojtjen nga zhurma : Nait Hasani, Salih Morina, Faton Topalli, Rasim Demiri dhe Boban Todoroviq.
3. Grupi punues për infrastrukturë mjedisore : Sevdije Lama, Daut Hajradini dhe Faton Topalli.
4. Grupi punues për ndryshim plotësim për banesat : Nait Hasani, Afërdita Berisha dhe Rasim Demiri.
5. Grupi punues për regjistrimin e bujqësisë : Faton Topalli, Ramiz Lladrovci dhe Salih Morina.

4. Konfirmimi për leximin e dytë të projektligjit për Kimikate

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin për projektligjin e kimikateve i cili ka kaluar në komisionet e përhershme dhe ftoi komisionin për të përcjell në leximin e dytë :

P Ë R F U N D I M

Projektligji për Kimikate përcjellët në leximin e dytë sipas raportit për rekomandim dhe vërejtje konkrete.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u shqyrtuan dhe u sugjeruan këto çështje :

1. **Sevdije Lama** hapi diskutimin rreth degradimit të lumenjve në Kosovë, dhe pas kërkesës së disa anëtarëve të komisionit për sqarim se çfarë propozon konkretisht, ajo sugjeroi që komisioni të hartoi një plan gjeneral bashkërisht me MMPH ngase lumenjtë janë asete që duhet të mbrohen. Pas ndërhyrjes së **Ramiz Lladrovci, Salih Morinës, Faton Topallit** Komisioni u pajtua që fillimisht të kërkohet raport nga MMPH ose të ftohet Ministri ngase duhet të ekzistoi pasqyra sa është zbatuar vendimi për rehabilitimin e vendeve (lumenjve) të dëmtuara. **Nait Hasani** tha se kjo iniciativë paraprakisht duhet të ketë donatorët e sigurt ngase ka implikime të mëdha financiare.
2. **Nait Hasani** njoftoi për kërkesën e ish Entit të Pejës për verëra dhe vreshtari për jomonopolizimin e Entit në Rahovec, ngase edhe në rajonin e Pejës mbillen vreshtat, ndaj sugjeroi që të kërkohet një sugjerim apo raport nga Ministria e bujqësisë lidhur me këtë temë (kërkesë nga Peja).
3. Pasi që gjatë dëgjimit publik për projektligjin për mbrojtjen nga zhurma është vendosur për një **vizitë të Komisionit në Turqi**, u caktuan 8 anëtarë për këtë vizitë prej datës 26 shkurt deri 1 mars 2014, me donacionin e Parlamentit të Turqisë dhe donatorëve.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani